

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT

PËR NJOHJEN E PERIUDHAVE TË PUNËSIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE, NË ISH-NDËRMARRJET SHTETËRORE, NË ISH-NDËRMARRJET BUJQËSORE DHE NË ISH-KOOPERATIVAT BUJQËSORE PËR EFEKT PENSIONI NË SISTEMIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “*Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore*”, ka për qëllim njohjen si periudhë sigurimi, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, të periudhave të punësimit në ish-ndërmarrjet shtetërore, institucione shtetërore, në ish-ndërmarrje bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në këtë projekt akt.

Objektivi që synohet të arrihet nëpërmjet miratimit të këtij projektligji, është njohja e periudhave të punës në institucionet dhe në ish-ndërmarrjet shtetërore deri më datë 1.10.1993, data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 7703/1993; në ish-ndërmarrjet bujqësore deri më datën e hyrjes në fuqi të VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “*Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore*”, i ndryshuar dhe në ish-kooperativat

Relacion për projektligjin “*Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore*”

bujqësore deri më datë 19.7.1991, data e hyrjen në fuqi e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Grumbullimi i dokumentacionit të vjetërsisë në punë para vitit 1994, të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve shtetërore, ndërmarrjeve bujqësore dhe kooperativave bujqësore, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 464, datë 22.07.1998 *“Për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të sigurimit të punonjësve të ish-kooperativave bujqësore, ndërmarrjeve dhe institucioneve që kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre, ose janë në procesin e mbylljes”*, sistemimi, administrimi dhe shfrytëzimi i tij, në strukturat arkivore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 19.11.2004 *“Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore”*, të ndryshuar, evidentoi problematika të konsiderueshme, si: mungesë e plotë të dhënash, të dhëna të pjesshme, të korrigjuara, të fshira, identitete të pasakta, fletë të dëmtuara, mungesë dokumentacioni për subjekte të caktuara etj.

Për shkak të problematikave të sipërpërmendura dhe kompetencave të kufizuara të strukturave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, periudha të konsiderueshme vjetërsie në punë, nuk janë konfirmuar dhe nuk janë njohur administrativisht, me pasojë refuzimin e kërkesave për caktim pensioni, sepse duke qenë se në shumë raste kërkesit nuk kishin periudha kontributive pas vitit 1994, nuk plotësohej kushti minimal i periudhës së sigurimit, gjë që ka detyruar shumë qytetarë t’i drejtohen gjykatave me kërkesëpadi për njohjen e këtyre periudhave, proces i cili zgjat në kohë dhe ka shpenzime të mëdha, e shpesh të papërbalueshme.

Miratimi i këtij projektligji, do të mundësonte njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, siç ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht, pa shpenzime për përfituesit dhe mbi të gjitha do të mundësonte përfitimin e një pensioni, të pakten sa masa e pensionit social.

Relacion për projektligjin *“Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”*

Kushtet e përfitimit të pensionit të pleqërisë, sipas neneve 31 dhe 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndryshojnë sipas gjinisë, për vitin 2024, moshë për përfitimin e pensionit të pleqërisë për burrat është 65 vjeç, për gratë është 61 vjeç e 8 muaj, ndërsa periudha minimale e sigurimit është e njëjtë për të dyja kategoritë, 15 vite.

Nenet 3, 4 dhe 5, të këtij projektligji, parashikojnë njohjen si periudhë e përgjithshme sigurimi, nga moshë 18 vjeç, duke parashikuar që në secilin subjekt të njihet vjetërsi pune, që së bashku me periudhë sigurimi nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, të plotësohet të paktën kushti minimal i periudhës së sigurimit për përfitim pensioni pleqërie (15 vite), konkretisht:

Burra:

Moshë për pension pleqërie 2024	Periudha e njohjes sipas projektligjit			
	Neni	Fillimi (18 vjeç)	Mbarimi	Gjithsej (rreth)
65 vjeç Vitlindja 1959	3	1977	1.10.1993	16 vite
	4	1977	19.7.1991	14 vite
	5	1977	17.10.1992	15 vite

Gra:

Moshë për pension pleqërie 2024	Periudha e njohjes sipas projektligjit			
	Neni	Fillimi (18 vjeç)	Mbarimi	Gjithsej (rreth)
61 vjeç e 8 muaj Vitlindja 1962	3	1980	1.10.1993	13 vite
	4	1980	19.7.1991	11 vite
	5	1980	17.10.1992	12 vite

Relacion për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”

Periudha e mësipërme, në rastin e njohjes së periudhës së sigurimit sipas shkronjës “b”, të nenit 3, të projektligjit, reduktohet në varësi të datës së kryerjes së studimeve të larta. Shkolla e lartë, për gratë, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, që ju lind e drejta për pension deri më datë 31.12.2032, njihet periudhë sigurimi për efekt pensioni. Gjithashtu, periudha e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak, bazuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703/1993, të ndryshuar, njihet periudhë sigurimi për efekt pensioni.

Parashikimi, për njohjen si periudhë të përgjithshme sigurimi për pensione të pacaktuara në datën e hyrjes në fuqi dhe atyre që janë në shqyrtim administrativ apo gjyqësor, është për shkak se njohja pa kufizim/dhënia e efektit me prapaveprim, sjell jo vetëm mosbarazim në totalin e njohjes së viteve, por sjell edhe efekte financiare të mëdha dhe të paparashikueshme. Duhet marrë në konsideratë që përgjithësisht, periudhat e vjetërsisë në punë me problematika, për pensione të caktuara në vite, janë njohur me vendime gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë ky projektligj nuk ka efekt në masën e tyre (pensioneve). Projektligji ju jep zgjidhje kategorisë që janë ende pa një pension, sepse nuk kanë arritur të plotësojnë kushtin minimal të periudhës së sigurimit dhe që mund të jenë në shqyrtim administrativ apo gjyqësor dhe patjetër edhe kategorisë që ju lind e drejta për pension nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji e në vijim.

Konkretisht, në aspektin financiar nëse të drejtat e përfitimit nga ky ligj do të shtrihen në kohë me prapaveprim, përbën një kosto mjaft të lartë . Në vlerësim të viteve të munguara për përfitues vetëm nga viti 2015 me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 104/2014, për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703/1993, i ndryshuar deri më vitin 2023:

- Për personat që kanë punuar në ish-Kooperativa Bujqësore, rezultojnë 3,5 milion muaj të munguara ose 285 mijë vite ku në llogaritje me një vjetërsi të plotë sa kërkohet në vitin 2023 prej 38 vitesh, me një pension mesatar 18,000 lekë në muaj, rezulton një kosto vjetore e shtuar për 7,500 pensione në vlerën 1,7 miliard lekë në vit.
- Për personat që kanë punuar në ish-ndërmarrje shtetërore rezultojnë 10 milion muaj të munguara ose 827 mijë vite ku në llogaritje me një vjetërsi të plotë sa

Relacion për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”

kërkohej në vitin 2023 prej 38 vitesh, me një pension mesatar (periudhë sigurimi në sektorin shtetërorë) 22,000 lekë, rezulton një kosto vjetore e shtuar për 22 mijë pensione, në vlerën 5,2 miliard lekë në vit.

Pra kemi një kosto minimale të shtuar vjetore 6,9 miliard lekë në vit, kosto kjo që shtohet nëse për çdo rast që do të vlerësohet për pensionet e caktuara nga janari i vitit 2015, jo me një vjetërsi të plotë me 38 vite, por me një vjetërsi sipas kushteve të nenit 92 të ligjit 7703/1993, i ndryshuar nga 35 vite deri në 38 vite.

Gjithashtu në vlerësim të kohës mesatare të gëzimit të pensionit prej 15 vitesh, minimalisht për përfituesit nga janari i vitit 2015 po llogarisim edhe një periudhë prej 8 vitesh për vazhdimësinë e gëzimit të pensionit dhe kosto për këta përfitues si rezultat i përfitimit nga ky ligj, shkon në 55,2 miliard lekë. Këto janë llogaritje të një kostoje minimale të mundshme, se për rastet që kanë përfituar pension pas vitit 2015, në vitet në vazhdimësi nga 2016 deri në 2023 koha e gëzimit të pensionit është më e lartë se një mesatare prej 8 vitesh dhe kostot si rezultat i shtrirjes në kohë kanë një vlerë më të lartë se 55,2 miliard lekë.

Në llogaritje, nëse përfitues nga ky projektligj do të përfshiheshin edhe kategoria e personave që kanë dalë në pension para janarit të vitit 2015, kostot financiare janë shumë më të larta se ato që u analizuan më sipër.

Konkretisht, në aspektin financiar nëse të drejtat e përfitimit nga ky ligj do të shtrihen me efekt nga hyrja në fuqi, kostoja financiare ka efektë më të ulëta. Në vlerësim të viteve të munguara për përfitues nga viti 2015 me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 104/2014, për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703/1993, i ndryshuar deri më vitin 2023 për personat në pension me vjetërsi pune në ish-KB, ish-NB dhe ish ndërmarrje shtetërore rezultojnë 1,112,000 vite të munguara në përlllogaritje me një vlerësim vjetërsie prej 16 vite për këto kategori personash dhe me numrin e pensioneve të reja në këtë hark kohor rezultojnë për kategorinë e periudhave për efekt pensioni para datës 01.10.1993 rreth 12 përqind vjetërsi e munguar.

Nga ky 12 përqind e vjetërsisë së munguar, vjetërsitë në ish KB zënë peshën 25.6 përqind dhe vjetërsitë për ish-NB, ish ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore zënë peshën prej 74.4 përqind.

Relacion për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”

Sa më sipër në koncept të projektligjit, me efekt nga hyrja në fuqi, me një mesatare prej 40,000 pensione të reja në vit, me vjetërsinë maksimale sipas kategorive prej 16 vjetësh, me 12 % vite të munguara rezultojnë 76,800 vite të munguara për vitin e parë të zbatimit. Këto vite të munguara në llogaritje me një vjetërsi të plotë prej 38 vitesh me një pension mesatar 20,000 lekë rezultojnë një kosto vjetore e shtuar për 2,021 pensione, në vlerën rreth 40 milion lekë në vitin e parë. Gjithashtu në vlerësim të kohës mesatare të gëzimit të pensionit prej 15 vitesh kosto për këta përfitues si rezultat i përfitimit nga ky ligj është rreth 600 milion lekë.

Kjo kosto e shtuar është për llogaritje maksimale pasi për llogaritjet janë realizuar me vjetërsinë maksimale para 01.10.1993 nga mosha 18 vjeç prej 16 vitesh ndërkohë vjetërsia minimale për kategoritë përfituese nga ky ligj për kategorinë femra është 11 vite.

Në vitin e dytë të zbatimit kosto e shtuar vjetore si efekt i këtij ligji me një vjetërsi maksimale sipas kategorive në 15 vjet, është në vlerën rreth 37 milion lekë, ku me një kohë gëzimi pensioni prej 15 vitesh, kosto për këta përfitues është rreth 555 milion lekë.

Në vitet në vazhdimësi kosto e shtuar vjetore për zbatim të ligjit vjen me ritëm rënieje deri në shuarje totale për një periudhë maksimale prej 16 vjetësh. Në vlerësim të kostove vjetore të shtuara për kategoritë e përfitimit nga ky ligj efekti total i kostove të shtuara vit pas viti deri në 16 vite rezultojnë në rreth 5 miliard lekë.

Në këto kushte, projektligji, përcakton efektin nga momenti i hyrjes në fuqi dhe sjell zgjidhjen përfundimtare të njohjes së periudhave të vjetërsisë në punë, për kategorinë e personave që nuk ju konfirmohet nga dokumentacioni i vjetërsisë në punë i subjekteve, ul në mënyrë të ndjeshme proceset gjyqësore dhe ju siguron përfituesve të ardhura, për të paktën 15 vite sigurimi, që në përgjithësi janë sa një pension social.

Gjithsesi, është parashikuar që në rastet kur në kërkesat për caktim pensioni, deklarohen periudha në subjekte, detyra dhe funksione specifike, llogaritja e të cilave sjell efekte pozitive në masën e pensionit, me dakordësinë e kërkuarit, të

Relacion për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”

ndiqet procedura ligjore në fuqi për shqyrtimin, vlerësimin dhe njohjen e tyre për efekt përfitimi në sistemin e sigurimeve shoqërore.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në harmoni me nenin 78 dhe pikën 1, të nenit 83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk bën pjesë në aktet që kërkohet të ketë përafrim me “acquis communautaire”

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Projektligji përbëhet nga 11 nene si vijon:

Neni 1, i projektligjit, parashikon qëllimin e tij, konkretisht njohjen si periudhë sigurimi, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, të periudhave të punësimit në ish-ndërmarrjet shtetërore, institucione shtetërore, në ish-ndërmarrje bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë akt.

Neni 2, parashikon që njohja e periudhës së sigurimit sipas këtij akti, të bëhet vetëm kur kërkuesit i lind e drejta për caktimin e një pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, sepse edhe qëllimi i projektligjit është i tillë dhe kjo njohje nuk shërben për përfitime të tjera të mundshme në institucione të tjera.

Nenet 3, 4 dhe 5, parashikojnë njohjen si periudhë e përgjithshme sigurimi për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, të periudhës së punësimit në ish-ndërmarrjet shtetërore, institucione shtetërore, në ish-ndërmarrje bujqësore dhe në Relacion për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”

ish-kooperativat bujqësore, nga mosha 18 vjeç, apo nga data e mbarimit të shkollës së lartë, por jo më herët se krijimi i subjektit. Ndërsa datë përfundimi e periudhës së punësimit të njohur sipas këtij akti, është parashikuar:

- për institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore, data 1.10.1993, që është data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 7703/1993, sepse në zbatim të neneve 58 dhe 91, të këtij ligji, periudhat e sigurimit nga kjo datë (1.10.1993 e në vazhdim), njihen të tilla vetëm nëse janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore, të vërtetuara me listë pagesat e dorëzuara nga subjektet detyruese sipas procedurave të parashikuara;
- për ish-ndërmarrjet bujqësore, data 17.10.1993, që është hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 17.10.1992 “*Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore*”, me të cilin janë shpërndarë ndërmarrjet bujqësore ose njësitë e tyre që janë krijuar kryesisht nga toka të ish-kooperativave bujqësore;
- për ish-kooperativat bujqësore, data 19.7.1991, data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “*Për tokën*”, me të cilin toka ju shpërnda anëtarëve të kooperativave bujqësore.

Neni 6, parashikon që kërkesat për pension, në të cilat janë deklaruar periudha punësimi në ish-ndërmarrjet shtetërore, institucione shtetërore, ish-ndërmarrje bujqësore, ish-kooperativa bujqësore, në detyra/funksione specifike, llogaritja e të cilave ka efekte më të favorshme në masën e pensionit, se periudhat që njihen sipas neneve 3, 4 dhe 5, të këtij projekt ligji, me kërkesën e përfituesit ndjekin procedurën sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7, rregullon të drejtat e fituara nga ky akt, në zbatim të parimit të sigurisë juridike, duke parashikuar që rishqyrtimi i të drejtave të fituara mund të bëhet vetëm nëse vendimmarrja sjell masë më të lartë pensioni.

Neni 8, i projektligjit, parashikon shtrirjen e tij, konkretisht njohja e periudhave të punësimit sipas neneve 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, bëhet:

Relacion për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”

- a) Për pensione që nuk janë caktuar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, pavarësisht datës së plotësimit të moshës për përfitim.
- b) Për pensione kur kërkuesit i është caktuar pension nga sigurimet shoqërore, përpara datës së hyrjes në fuqi dhe janë në shqyrtim administrativ në Komisionin Rajonal të Ankimit dhe në Komisionin Qendror të Ankimit në ISSH, apo në proces gjykimi në gjykatë, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Nenet 9, 10 dhe 11, respektivisht parashikojnë institucionet që ngarkohen për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji, konkretisht Këshillin e Ministrave, Ministrinë përgjegjëse për sigurimet shoqërore dhe ISSH; parashikon që periudhat e punësimit të njohura me ligje të veçanta, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, vazhdojnë të njihen të tilla dhe nuk janë objekt trajtimi sipas këtij ligji

VI. “PERSONAT DHE INSTITUCIONET QE KANE KONTRIBUAR NE HARTIMIN E PROJEKTAKTIT”

Për hartimin e këtij projekt akti ka kontribuar Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Ngarkohet për zbatimin e këtij akti, Këshilli i Ministrave, që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me propozim të Ministrisë përgjegjëse për fushën e sigurimeve shoqërore dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas nenit 3 dhe 4 të këtij ligji, të miratojë listën e ish-kooperativave bujqësore dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore sipas vitit të krijimit të tyre me përcaktimin e territorit të ushtrimit të aktivitetit.

Ngarkohet Ministria përgjegjëse për fushën e sigurimeve shoqërore dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore që brenda 1 muaji nga miratimi i listës së ish-kooperativave Relacion për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”

bujqësore dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore, të nxjerrë rregulloren për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hollësishme për zbatim.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projekt ligj parashikon njohjen e periudhave të punës me efekt në pensionet që do të caktohen nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji duke pasur efekt në kalkulimin fillestar të pensioneve pas kësaj date. Efektet financiare të zbatimit të këtij ligji përbëjnë pjesë organike të sistemit të pensioneve dhe përballohen sipas parashikimit për cdo vit në buxhetin vjetor për pensione të Sigurimeve Shoqërore. Në parashikimin vjetor në buxhetin e pensioneve do të rezultojë një kosto e shtuar për cdo vit si rezultat i numrit më të lartë të pensioneve si dhe masave më të larta të pensioneve për kategoritë përfituese nga ky ligj. Sipas analizës financiare kosto e shtuar, në vitin e parë të zbatimit, rezulton rreth 40 milion lekë. Gjithashtu në vlerësim të kohës mesatare të gëzimit të pensionit prej 15 vitesh kosto për këta përfitues si rezultat i përfitimit nga ky ligj është rreth 600 milion lekë. Në vlerësim të kostove vjetore të shtuara për kategoritë e përfitimit nga ky ligj efekti total i kostove të shtuara vit pas viti deri në 16 vite rezulton në rreth 5 miliard lekë.

Ky Ligj parashikohet të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi.

MINISTËR

Blendi GONXHJA

Relacion për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”